

GP Liria e Lëvizjes/ Konkluzionet për Urën, 25 gusht 2015/2

1. Të dyja palët kanë kërkuar nga BE që të revitalizohet ura e Mitrovicës dhe hapësira rreth sajë, sipas rekomandimeve të vlerësimit teknik dhe bazuar në dizajnin arkitekturor të 29 Qershor 2015 të dakorduar mes palëve.
2. Me 15 tetor 2015 kontraktuesi do të mbyll të dyja anët e urës me pengesa të palëvizshme dhe rrethojë të punimeve. Punimet në urë do të bëhen duke ju qasur vend punimit nga ana jugore e rrugës. Ura do të hapet për qarkullim të përgjithshëm në verë / jo më vonë se fundi i Qershori 2016.
3. Në përputhje këto afate kohore, komuna do të revitalizoj rrugën e saj kryesore (rruga Mbreti Peter) në zonë për këmbësorë. Rruga do të hapet për këmbësorë në verë / jo më vonë se fundi i Qershorit 2016.
4. GP do të mbikëqyr dhe rishikoj rregullisht së bashku me të dy kryetarët e komunave kushtet mbizotëruese politike dhe të sigurisë në komuna gjatë procesit të revitalizimit.
5. Me 10 tetor 2015 hartat e linjave administrative të zonave kadastrale në Suhodoll/Suvi Do dhe Kroi i Vitakut/Brdjani do të zgjidhen përmes Memorandumit të Mirëkuptimit për Planet Zhvillimore Komunale, Hartës se Zonimit Komunal dhe Planit Rregullues të Detajuar nga ministritë relevante dhe dy komunat.